

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi kryetare e kolegjit, Gani Zabeli dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Përparim Zeka, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.L. nga Gjilani, rruga "...", pa nr., për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 335 par. 5 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit G.L. av.SH.P., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.874/2018, datë 22.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), më datë 24.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit G.L. av. SH.P., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.874/2018, datë 22.10.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.874/2018, datë 22.10.2018, të akuzuarin G.L., e ka shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi, nga neni 335 par. 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 8 (tetë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) €, të cilin dënim është obliguar ta paguaj në afat prej 8 (tetë) muajve, nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë dhe e cila pagesa duhet të bëhet në fillim të javës së parë të çdo muaji vijues, në këste të barabarta, duke pjesëtuar shumën e lartë cekur. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk është në gjendje të paguaj dënimin me gjobë, atëherë dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, në pajtim me të akuzuarin zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20 (njëzet) € të gjobës, ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € të gjobës do t'i llogaritet në një ditë burgim. Të akuzuarit konform nenit 62 par. 2 pika 2.3 të KPRK-së, i është shqiptuar edhe dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë dhe atë në aktivitetet e agjencive të udhëtimeve në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, afat ky i cili do të rrjedh pas mbajtjes së dënimit me burgim.

I akuzuari është obliguar që të dëmtuarve të ju paguaj shumën e të hollave për kompensimin e dëmit në emër të kërkesës pasurore juridike, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe atë për M.B. shumën prej 569 €, A.S.-Z. shumën prej 1600 €, F.B. shumën prej 1400 €, B.SH. shumën prej 2500 €, F.P. shumën prej 1260 €, G.R. shumën prej 1200 €, I.M. shumën prej 2320 €, B.H. shumën prej 7797 €, B.I. shumën prej 3050 €, B.B. shumën prej 6800 €, I.Z. shumën prej 2100 €, M.SH. shumën prej 680 €, L.M. shumën prej 1600 €, K.SH. shumën prej 4890 €, A.S. shumën prej 3050 €, F.R. shumën prej 1275 €, SH.F. shumën prej 3140 €, F.H. shumën prej 1225 €, V.SH. shumën prej 1700 €, E.J. shumën prej 1275 €, E.S. shumën prej 7995 €, V.M. shumën prej 2800 €, SH.SH. shumën prej 3020 €, N.A. shumën prej 2730 €, D.G. shumën prej 2180 €, A.G. shumën prej 1225 €, H.SH. shumën prej 4687 €, L.K.-V. shumën prej 2500 €, V.K. shumën prej 3610 €, SH.H. shumën prej 3500 €, F.K. shumën prej 1100 €, A.B. shumën prej 1474 €, F.J. shumën prej 1020 €, B.R. shumën prej 1281 €, E.B. shumën prej 2000 €, G.D. shumën prej 4000 €, S.G. shumën prej 1952 €, SH.B. shumën prej 5200 €, J.A. shumën prej 372 €, Z.SH. shumën prej 1200 €, M.A. shumën prej 702 €, M.R. shumën prej 1000 €, V.Q. shumën prej 3300 €, I.K. shumën prej 2080 €, N.M. shumën prej 1200 €, A.S. shumën prej 7400 €, M.S. shumën prej 250 € dhe A.V. shumën prej 1500 €.

Të akuzuarit G.L. pas shpalljes së aktgjykimit P.nr.874/18, i është vazhduar paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më gjatë se koha e dënimit të shqiptuar me aktgjykim.

Konform nenit 83 të KPRK-së, të njëjtit koha e kaluar në paraburgim nga data 06.08.2018, e deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit, i është llogaritur në dënimin e shqiptuar më lartë.

I akuzuari është obliguar që të kompensoj shpenzimet e procedurës penale sipas përlllogaritjeve përfundimtare të gjykatëse, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) €, si dhe për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) €, të gjitha këto në afati prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit G.L. av. SH.P. dhe atë vetëm për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të butë sipas ligjit.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1218/2018 të datës 27.11.2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konform dispozitave të nenit 390 të KPP-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën i njoftoj palët, dhe atë Prokurorin e Prokurorisë së Apelit, të akuzuarin G.L. i dhe mbrojtësin e tij av. SH.P., dhe të dëmtuarit: M.B., A.S.-Z, F.B., B.SH., F.P, G.R. €, I.M. €, B.H., B.I, €, B.B., I.Z., M.SH., L.M., K.SH., A.S., F.R., SH.F., F.H., V.SH., E.J., E.S., V.M., SH.SH., N.A., D.G., A.G., H.SH, L.K.-V., V.K., I.SH., SH.H., F.K., A.B., F.J., B.R., E.B., E.B.1, E.B., G.D., S.G., SH.B., J.A., Z.SH, M.A., M.R., V.Q., I.K., N.M., A.S., M.S. dhe A.V.. Në seancë

prezantuan të dëmtuarit F.P., I.Z., K.SH., H.SH., SH.H., F.K., M.R., I.K. dhe A.V., të cilët deklaruan se i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe parashtrajnë kërkesë pasurore juridike. Po ashtu, në seancë prezantoi edhe mbrojtësi i të akuzuarit av. SH.P., i cili deklaroi se mbet në tërësi pranë ankesës së tij të bërë me shkrim, njëherit propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë, edhe i akuzuari G.L. i cili prezantoi në seancë dhe i shoqëruar nga Njësiti i Policisë për Transportin e të Burgosurve deklaroi se e mbështet në tërësi ankesën e mbrojtësit të tij të bërë me shkrim dhe fjalën e tij në seancë, tjetër nuk ka çka të shtoj. Palët tjera, edhe pse të njoftuara me kohë dhe në mënyrë të rregullt, nuk prezantuan në seancë.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresa e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPP-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPP-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit për dënim, në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit pretendohet se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë është i ashpër, gjykata e shkallës së parë me rastin caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, mirëpo rrethanat lehtësuese edhe pse të cekura nga gjykata e shkallës së parë, nuk janë elaboruar në masë të mjaftueshme, njëherit thekson se kanë ekzistuar edhe rrethana tjera lehtësuese të cilat gjykata e shkallës së parë nuk i ka potencuar, e të cilat do të ishin me ndikim që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe atë sjellja e mëparshme dhe rrethanat personale të kryerësit, se i njëjti në jetën e mëparshme ka pasur sjellje korrekte dhe ka qenë shembull për të mirë në vendin ku ka jetuar dhe ka vepruar. Thekson se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale, pranim ky i cili tregon se i njëjti është penduar dhe në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale dhe do të silllet mirë. Përveç kësaj thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave lehtësuese, nuk e ka vlerësuar faktin e rëndësishëm dhe atë sjelljen e mirë të kryerësit pas kryerjes së veprës penale, e që tregon qëndrimin e kryerësit ndaj veprës së vet, se çfarë sjellje do të ketë në të ardhmen dhe gatishmëria e palëkundur e të akuzuarit që të gjithë të dëmtuarit t'i kompensoj, pra

t'ua kthej parat për të cilat janë dëmtuar nga kryerja e veprës penale. Më tej, mbrojtësi në ankesë pretendon se rrethana rënduese se i akuzuari ka të përfunduar 3 fakultete, në mesin e tyre edhe Fakultetin Juridik, nuk qëndron, për faktin se përgatitja profesionale assesi nuk mund të merret si bazë për aplikimin e rrethanës rënduese në shqiptimin e dënimit, e në realitet i akuzuari nuk i ka të përfunduar 3 fakultete ashtu siç konkludohet në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar dhe një qëndrim i tillë i gjykatës së shkallës së parë është i papranueshëm. Andaj, duke pasur parasysh të lartë cekurat, mbrojtësi i të akuzuari konsideron se edhe me shqiptimin e një dënimi më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozita përkatëse ligjore.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit për shqiptimin e një dënimi më të butë, në rastin konkret nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform dispozitës së nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë për bazë faktin se i njëjti në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, është penduar për kryerjen e veprës penale, sjelljen e tij të mirë gjatë shqyrtimit fillestar, se i njëjti është i moshës së re, si dhe faktin se ka shprehur keqardhje për veprimet e bëra me rastin e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, faktin se përmes kësaj vepre penale janë dëmtuar 50 persona, ku janë shkaktuar pasoja shumë të rënda dhe të dëmshme për të njëjtit edhe për anëtarët e familjeve të tyre, motivet për kryerjen e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së kryerësit të veprës penale, si dhe faktin se i njëjti ka të përfunduar tre fakultete, në mesin e tyre edhe fakultetin juridik, ku në prani të këtyre rrethanave të njëjtit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante për matjen e dënimit, si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, dhe gjen se në praninë e rrethanave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi më të butë, siç pa të drejtë pretendon mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë. Rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate pjesërisht kanë qenë objekt vlerësimi nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por kjo gjykatë vlerëson se edhe në prani të rrethanave tjera lehtësuese të pretenduara me ankesë nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi më të butë, sepse duke pas parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e duke veçuar faktin se në rastin konkret vepra penale është kryer ndaj shumë personave dhe me pasoja të mëdha, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit me burgim efektiv nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit. Pretendimi në ankesë se përgatitja profesionale dhe atë se i akuzuari ka të përfunduar 3 fakultete, në mesin e tyre edhe Fakultetin Juridik nuk mund të merret si rrethanë rënduese, sipas vlerësimit të kolegjit penale të kësaj gjykate një pretendim i tillë qëndron, mirëpo në veprimet e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale qëndrojnë edhe rrethana të tjera rënduese të cilat janë të asaj rëndësi që justifikojnë shqiptimin e dënimit me burgim të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, prandaj në prani të rrethanave rënduese dhe lehtësuese të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë,

kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.1214/2018 datë 24.12.2018

Bashkë. profesional
Përparim Zeka

Kryetare e kolegjit
Shqipe Qerimi

Anëtarët e kolegjit

Gani Zabeli
Ferit Osmani